



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2021:138849

Datë: 16.01.2023

Numri i dokumentit: 03859398

PPP.nr.759/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen përmbaremore të kreditorit të përbarimit: M. (A.) S. me numër personal ..., me adresë në Vushtrri, ndaj debitorit të përbarimit: N.Sh “V. B.”, rr.“...”, lagja ... nr... në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson I. S. avokat në Prishtinë, për kërkesën në të holla- objekt i përbarimit, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit mbi Caktimin e Përbarimit P.nr.628/2021 i datës 21.04.2021 të Organit Përmbareues-Përmbareuesit Privat D.B., jashtë seance me datë 12.01.2023 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET SI I PABAZUAR prapësimi i debitorit të përbarimit: N.Sh “V. B.”, rr.“...”, lagja ... nr.... në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi Caktimin e P.nr.628/2021 i datës 21.04.2021 i Organit Përmbareues-Përmbareuesit Privat D. B.

**A r s y e t i m**

Organi Përmbareues-Përmbareuesi Privat D. B., i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit të përbarimit, me urdhërin P.nr.628/2021 i datës 21.04.2021 e ka caktuar përbarimin në këtë çështje përmbaremore në bazë të dokumentit përmbareues

- Aktit Noterial LRP.nr.2920/2020 i datës 26.02.2020 i cili sipas nenit 21 të LPP-së paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ndërsa në bazë të nenit 22 par. 1 pika 1.3 të këtij ligji janë dokumente përmbaruese.

Kundër urdhrit mbi caktimin e përmbarimit në këtë çështje përmbarimore, brenda afatit ligjor, ka paraqitur prapësim i autorizuari i debitori i përmbarimit me arsyetimin se, kundërshton në tërësi urdhërin për lejimin e përmbarimit, për faktin se i njëjti ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore, si dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Tutje ka shtuar se vonesat në dorëzimin e banesës kanë ardhur si rezultat i shfaqjes së fuqisë madhore, konkretisht pandemisë Covid 19, me vendimin e Qeverisë së Kosovës aktivitetet biznesore janë ndërpre prej datës 13.03.2020, për tre muaj, andaj kompensimi i qirasë në rast vonesash nga debitori të përcaktuara me kontratën noteriale nuk mund të aplikohet prej 3 muaj, si rezultat i pandemisë Covid 19, dhe si rezultat debitori nuk ka asnjë obligim ndaj kreditorit për 6 muaj. Bazuar në atë që u tha më lartë, ka kërkuar nga gjykata që pas shqyrtimit të prapësimit të merr aktvendim, dhe të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit si i bazuar, dhe të anulohet në tërësi urdhëri për përmbarim i lëshuar nga përmbaruesi privat.

Me përgjigje në prapësim, kreditori i përmbarimit pretendimin e debitorit të përmbarimit se vonesa në dorëzimin e banesës është si rezultat i pandemisë Covid 19, dhe vendimit të Qeverisë së Kosovës për ndërprerjen e punimeve, nuk qëndrojnë pasi që debitori dorëzimin e banesës ka pasur për ta bërë me datë 30.07.2020, dhe nuk kemi të bëjmë me tre muaj vonesë por i njëjti ende nuk e ka bërë dorëzimin e banesës. Tutje ka shtuar se, debitori nuk ka parashtruar asnjë dëshmi me të cilën dëshmon se nuk e ka borxh ndaj kreditorit, andaj në këtë bazë, prapësimi i debitorit nuk bazohet në asnjërin nga shkaqet e prapësimit të parapara me nenin 71 të LPP-së. Nga arsyet e cekura më lartë, i ka propozuar gjykatës që të merr aktvendim dhe të refuzoj në tërësi prapësimin si të pa bazuar, ndërsa urdhërin përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të prapësimit, analizimit të shkresave të lëndës, si në dispozitiv të këtij aktvendimi ka vendosur, pasi pretendimet e debitorit të përmbarimit në

prapësim i ka vlerësuar të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se provat e ofruara nuk i mbështesin pretendimet e tij ashtu siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin pjesërisht ose në tërësi të aktvendimit mbi caktimin e përmbarimit, apo për shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Gjykata, ka vlerësuar se dokumenti përmbarues- Aktit Noterial LRP.nr.2920/2020 i datës 26.02.2020, për borxhin e kërkuar nga kreditori i përmbarimit në shumën 1,350.00€, i plotëson kushtet për të shërbyer si titull ekzekutiv dhe bazë juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, 22 par.1.3 të LPP dhe nenit 43 par.1 të Ligjit për Noterinë Nr. 06/L-010, është i përmbarueshëm sipas nenit 26 par.1 pasi është përcaktuar afati i përmbushjes së detyrimit, është i përshtatshëm sipas nenit 27 par.1 të LPP-së për përmbarim pasi në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Ndërsa pretendimi i debitorin në prapësim se, dorëzimin i banesës kanë ardhur si rezultat i shfaqjes së fuqisë madhore, konkretisht pandemisë Covid 19, dhe vendimin të Qeverisë së Kosovës për ndërprerjen e aktiviteteve biznesore prej datës 13.03.2020, një pretendim i tillë nuk ishte me ndikim për gjykatën që të vendos ndryshe nga ajo që ka vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata sqaron se, në procedurë përmbarimore nuk ka tagër të lëshohet në shqyrtimin e ligjshmërisë së titullit ekzekutiv. Në procedurën përmbarimore vetëm bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të përcaktuar me dokumentin përmbarues i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të përmbarimit, të caktoi dhe zbatoi përmbarimin, në një çështje përmbarimore.

Gjykata, mbi bazën e asaj që është thënë më lart dhe, në bazë të nenit 44 par.3 dhe 73 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti i Përgjithshëm  
PPP.nr.759/2021, datë 12.01.2022

Gjyqtari  
Përparim Zeka

**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.